



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 4, Datë 19.4 2018

Për

Digën e “Zallit të Okshtunit”

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, e nenit 8, nenit 9, nenit 20 pika 2 dhe nenit 25, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 19.04.2018, mori në shqyrtim dhe diskutoi në lidhje me “Kërkesë për miratim të projekt Idesë së Digës Zalli i Okshtunit” si dhe shkresën nr. 2575/1 ardhur nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (Drejtoria e monitorimit të veprave Energjitike).

Në mbledhje morën pjesë zoti Shkëlqim Golli, Administrator “DITEKO” shpk, projektuesi zoti Fari Maho.

Sipas kërkesës nr.prot. 131/53 dt. 056.12.2017, për miratimin e projekt idesë të dërguar nga shoqëria “DITEKO”shpk si dhe përgjigjes së A.K.B.N-së nr.prot 2575/1, dt. 06.03.2018, rezulton se diga e Okshtunit me lartësi mbi 60m, është ndërtuar dhe mbushur me ujë. Diga është e tipit RCC, teknologji e përdorur për herë të parë në vendin tonë. Kronologjikisht rezulton :

1. Kontrata konçesionare është nënshkruar në Tiranë me nr.1924 Rep: nr.230 kol. në datë 03.06.2009 me Autoritetet Kontraktues, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës dhe Koncesionar bashkimin e disa shoqërive të kryesura nga shoqëria “Perxhola” shpk.

2. Miratimi i kontratës Konçesionare është bërë me VKM nr.701, datë 11.06.2009.
3. Projekti është miratuar në Këshillin Kombëtar të Teritorrit me Vendimin nr. 5, datë 01.06.2012.
4. Leja Zhvillimore Komplekse është zbardhur me nr.7361, datë 06.09.2013 nga Ministria e Ekonomisë, Trgetisë dhe Energjitikës.
5. Diga dhe rezervuari janë në shfrytëzim.

Mbas diskutimeve të anëtarëve të KKDM dhe KTPD, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha:

V E N D O S I :

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) i paraprin problemit të sigurisë së digave, në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004. Këto akte ligjore përcaktojnë këto etapa kryesore :

- Shqyrtimin dhe miratimin teknik të projekt-idesë në jo me pak se dy zgjidhje.
- Miratimin teknik të projekt-zbatimit simbas kërkesave të nenit nr.9 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM 147 datë 18.03.2004 me të gjithë treguesit.
- Miratimit të mbikqyrësit të veprës.
- Dhënies së autorizimit për mbushjen e rezervuarit për herë të pare, etj.

Në kushtet kur objekti ka përfunduar dhe është venë në shfrytëzim, KKDM impenjohet dhe njofton autoritetet përkatëse, për pamundësinë e marrjes së një vendimi të shprehur për miratimin teknik të projekteve të digës së ralizuar.

Me respekt,

Inxh. Maksim Muçi

K R Y E T A R

